

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**ME SELI NË TIRANË**

**“ASTRAL” SH.P.K**

Sot, më datë 22/03/2022 (dymijë e njëzetedy):

**Z. Sokol Kraja**, i biri i Gani dhe Ixhlal, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 04/06/1969, lindur në Tiranë dhe banues në adresën *Rruga Bardhok Biba, Galeria e Tiranës, Nr. 17, Tiranë, Shqipëri*, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.G90604128G

Përpilon këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare “ASTRAL” Sh.P.K, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare “ASTRAL” SH.P.K, themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, (këtu e më poshtë Shoqëria).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

**NENI 2**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “ASTRAL” SH.P.K . Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria ka për objekt veprimtarise te saj:

- Veprimtari ne fushen e ndertimit, prodhimi dhe tregtimi i materialeve te ndertimit, import eksporti i tyre brenda dhe jashte vendit per llogari te vete shoqerise dhe te treteve. Ndertime te ndryshme civile, industriale, social-kulturore te gjithe llojeve.
- Import – eksport dhe tregtim i artikujve ushqimor në përgjithësi, lendeve te para per prodhimin e tyre, etj te ngjashme;
- Import-eksport dhe shitje me shumice dhe pakice te mallrave e lendeve te para per industrine e ndertimit.
- Veprimtari me shitje-blerjen e pasurive te palujtshme, dhenien e marrjen e tyre me qira.
- Veprimtari ne fushen e turizmit, me qellim jo vetem ngritjen por edhe shfrytezimin dhe zhvillimin e veprimtarive ne fushen e hotelerise dhe te fshatrave turistike te pushimit, qendrave te argetimi, brenda dhe jashte vendit, si dhe te bleje, te marre dhe jape me qera, te ndertoje apo te nxise ndertimin e tyre, duke vepruar ne kete fushe apo me partnere te tjere. Bar- restaurant, veprimtari ne fushen e argetimit, si salla pingpongu, bilardoje dhe lojra te tjera argetuese.

- Administrimi i aktiviteteve tregtare apo dhënia me konçension të tretëve nëpërmjet kontratave frinching apo kontratave të ngjashme të aktiviteteve tregtare.
- Aktivitet për nxjerrjen dhe shfyrtezimin e rezervave minerare, prodhimin, tregtimin, import eksportin e tyre, etj te ngjashme
- Për arritjen e objektivave të shoqërisë, shoqëria do të ketë gjithashtu mundësinë të zhvillojë të gjitha operacionet tregtare, industriale, të luajtshme e të paluajtshme që do të konsiderohen të nevojshme të dobishme nga organi administrativ, duke përfshirë këtu blerjen e pasurive të paluajtshme edhe me anë të qerasë financiare, lëshimin e tyre me qera, lëshimin e dorëzansisë dhe garancive të tjera personale e pasurore si për llogari të të tretëve, ashtu edhe pa shpërblim.
- Gjithashtu shoqëria, do të ketë mundësinë të zhvillojë operacione financiare me qëllim të vetëm realizimin e objektit kryesor të veprimtarisë së saj. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj duke u bazuar tek autorizimet dhe /ose lejet e lëshuara nga institucionet qeveritare kompetente të fushës.

#### **NENI 4**

##### **Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Autostrada Tirane-Durres, km 8.8, Picar, Zona Kadastrale nr 3974, Nr pasurie 249/76, Vorë, Shqipëri.

#### **NENI 5**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakut të vetëm themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kontributi në para do të jetë i përbërë prej një kuote me vlerë 100,000 (njëqindmijë) lekë.

Ortaku themelues i Shoqërisë zotëronë kuotat si më poshtë:

1. Z. Sokol Kraja, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100% të kapitalit fillestar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë me vlerë 100,000 (njëqindmijë)lekë.

Kapitali themeltar është derdhur tërësisht nga ortakut themelues. Vlera dhe pagesa e e kapitalit themeltar do të kryhet në momentin e nënshkrimit të këtij akti themelimi.

#### **NENI 6**

##### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të papërcaktuar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.

#### **Neni 7**

##### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë.

Shoqëria administrohet nga ana e Administratori i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rrizgjedhje. Administratori i shoqërisë do të jetë Z. Agron Kryekurti, i cili e ka pranuar këtë detyrë.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me përcaktimet e bëra në Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 8**

Audituesi ligjor i shoqërisë do të emërohet në përputhje me me legjislacionin përkatës në fuqi dhe për çdo vit financiar shoqëria do të emërojë një auditues ligjor për të kontrolluar aktivitetin ekonomik të shoqërisë nëse përmbushen kriteret e ligjit për caktimin e ekspertit kontabël.

#### **NENI 9**

Ortaku themelues mund të vendosë me vullnetin e tij, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 11**

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 12**

##### **Legjislacioni i aplikuar**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakët themelues dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

#### **NENI 13**

##### **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve apo ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

#### **NENI 14**

##### **Dispozita Përfundimtare**

Akti i themelimit përpilohet në katër kopie të njëjta në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje prej tij.

#### **ORTAKU THEMELUES**

**SOKOL KRAJA**

